


ANEKSI 1.1

POZICIONI GJEOGRAFIK - "Porti MBM", Porto-Romano, Durrës

Pjesa e pare:

Zona e individualizuar ku do te vendosen bovat MBM, ndodhet në afërsi të bregdetit shqiptar mbi 2,500 m nga vija bregdetare në afërsi të Porto-Romanos, Durrës, brenda koordinatave:



Pjesa e dytë është pjesa e distributorëve shpërndarës. Distributorët shpërndarës shërbejnë për lidhjen e operatorëve të ndryshëm që duan të shfrytëzojnë Portin MBM. Salla e kontrollit ndodhet në koordinatat:

Pika "P1" N-41°22'32.520"
E-19°25'19.200"

Për të kryer operacionet në tokë duhet një sipërfaqe toke prej 3,850 m². Kjo sipërfaqe është paralele me rrugën ekzistuese për në Romano-Porto me distancë 12 ml nga aksi i saj, për të mos penguar edhe zgjerimin në perspektivë të kësaj pjese të rrugës. Sipërfaqja e nevojshme është në formë paralelogrami (me gjatësi mesatare) 77 ml dhe gjerësi 50 ml dhe me sipërfaqe 3,850 m². Brenda këtij sheshi duhet të ndërtohet infrastruktura e nevojshme për shfrytëzimin optimal të portit MBM. Për përmirësimin e shërbimit të operacioneve në tokë do të përdoret edhe një sipërfaqe prej 7315 m² e cila është në posedim dhe përdorim nga koncesionari, referuar kartelave të pasurive në ZK 3184, nr. pas 93/2, dhe nr. pas 94/2

Pjesa e tretë është e ndarë në tre sektorë:

- a- Sektori i argjinaturës mbajtëse të tubave me shtrirje nga vija e intercektimit të tokës me detin me gjatësi 1378ml, në det, me profil gjatësor nga +/-0.00 deri në thellësinë -10.00 me gjerësi të pjesës së sipërme të argjinaturës 10 ml.

Koordinatat gjeografike të kësaj argjinature janë:

Pika "P2" N-41°22'25.07148"
E-19°24'49.41114"

Pika "P3" N-41°22'33.29830"
E-19°25'18.43707

Pika "P4" N-41°21'49.92000"
E-19°24'32.30000"

Pika "P5" N-41°21'50.48000"
E-19°24'35.27000"


- b- Sektori i shtrirjes së tubave nga argjinatura në taban të detit është me gjatësi mbi 1250ml deri në sektorin e bovave të lidhura me Plemën.

Tubacionet për sektorin a dhe b do të jenë me diametër 323.9 mm. Keto tubacione janë të mbrojtur me shtresë gome, dy prej te cileve janë të veshur me beton me trashësi 2 cm, për ruajtjen

nga goditjet mekanike të mundshme dhe ai që do të shërbejë për transportimin e bitumit do të jetë i pajisur me kundërtub për kontrollin e temperaturës.

c-Në anën jugore të kësaj argjinate ndodhen kalatat 1,2,3 për akostimin dhe përpunimin e mjeteve lundruese që transportojnë hidrokarbure, të pozicionuara përgjatë argjinaturës.

Tubacionet që do të shërbejnë për transportimin e lëndëve hidrokarbure, si psh: diesel, benzene, mazut, solare naphta, biokarbonat, bitum, naftë bruto, etj., duhet të përmbushin standardet në fuqi.



Pjesa e katërt:

Është argjinatura mbrojtëse e strukturës e vendosur në anën jugore të saj, me formë planimetricke si në skicën me sipër. Kjo strukturë është me gjatësi mbi 500 ml, me konfiguracionin e tillë që të përballojë dallgëzimin maksimal të detit dhe për mbrojtjen e gjithë strukturës në det.

Në gjatësinë e kësaj argjinate vendosen kalatat Jug-Lindore me numër 4,5,6 për përpunimin e mjeteve lundruese që transportojnë mallra të tjera.

Koordinata gjeografike të kësaj argjinate janë:

Pika "P6" N- 41°22'15.47132"
E-19°25'06.45369"

Pika "P7" N- 41°22'08.19861"
E- 19°24'47.41062"

Pika "P8" N- 41°22'07.89630"
E-19°24'43.12646"

Pika "P9" N- 41°22'09.16808"
E- 19°24'38.71361"

Pika "P10" N- 41°22'12.34902"
E-19°24'34.95584"

Pika "P11" N- 41°22'16.33018"
E- 19°24'33.96351"

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]